



Buletini Mjedisor

MINISTRI KOKA: "PYJET PASURIA JUAJ, RUAJENI SE NUK TJETËRSOHEJ!"



Ministria e Mjedisit si çdo verë ka në fokus të punës së saj situatën e pyjeve, të cilat në çdo vit në muajt e nxehhtë, rrezikohen të jenë pre e zjarreve, herë nga klima, e herë nga veprimet e qëllimshme të njerzve. Njohja me situatën aktuale, masat e marra dhe kërkimi i ndihmës nga çdo banor pranë këtyre pasurive natyrore, ishte arsyeja e daljes për konferencë për shtyp, e Ministrisë së Mjedisit, Z. Lefter Koka, në javën e parë të korrikut. Ministri Koka u shpreh se "me mbërritjen e sezonit veror, ka filluar problematika e shfaqjes së zjarreve në fondin pyjor dhe kulloror. Gjatë ditëve të fundit janë konstatuar disa raste të shfaqjes së zjarreve, si në Baldren dhe Kakarriq të qarkut Lezhë, në Gjirocë, Mat dhe Bulqizë të qarkut Dibër apo në rrethin e Fierit. Nga verifikimet e bëra rezultoi se këto zjarre sipërfaqësore kanë qenë të qëllimshme dhe po hetohen nga organet kompetente për zbulimin e autorëve." – ka thënë Ministri i Mjedisit duke theksuar më tej se strukturat përkatëse për menaxhimin e zjarreve kanë bërë një punë mjaft të mirë në minimizimin e

dëmeve dhe neutralizimin e të gjitha vatrave të shfaqura. Më tej, ministri Koka informoi publikun nëpërmjet medias se Ministria e Mjedisit duke marrë në konsideratë situatën e krijuar gjatë viteve të mëparshme, problemet shqetësuese të shkaktuara prej zjarreve, por edhe bashkëpunimin e frytshëm të një viti më parë, ka mundësuar hartimin e një plani pune të përbashkët operacional me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku është përfshirë edhe Shtabi i Emergjencave Civile. Gjatë këtij muaji janë vënë në funksionim shtabet rajonale dhe lokale, ku janë të përfshirë përfaqësues të pushtetit vendor, strukturat e varësish së ministrive përkatëse. Gjithashtu, këtë vit është aktivizuar sistemi i vrojtim-sinjalizimit bazuar në një skemë efektive menaxhimi. Në këtë sistem janë përfshirë rreth 110 vrojtues, sinjalizues dhe roje mjedisore nga Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve, si dhe 130 punonjës të punësuar me kontrata provizore. Gjithashtu, është vënë në gadishmëri të plotë e gjithë baza materiale dhe logjistike ekzistuese. Në deklaratën e tij, Ministri

Koka theksoi se: "Të dhënat e shfaqjes së zjarreve gjatë sezonit të verës në vite, tregojnë se mbi 90 për qind e rasteve janë zjarre të qëllimshme ose njerëzore dhe pjesa tjetër janë faktorët natyrorë që kanë ndikuar në rënien e zjarreve. Bazuar në këto të dhëna, i bëj thirrje të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, të sensibilizohen dhe të tregojnë kujdes maksimal në mbrojtjen e mjedisit tonë. Për çdo rast të evidentimit të zjarreve të sinjalizojnë strukturat përkatëse në nivel lokal dhe të emergjencave civile dhe të japin kontributin e tyre vullnetar. Theksoj se të gjitha ata që do të tentojnë të vënë zjarre të qëllimshme për të tjetërsuar sipërfaqen pyjore dhe kullorore do të ndiqen penalisht në bazë të ligjeve në fuqi. Çdo sipërfaqe e djegur nuk do të tjetërsohet, por do të rehabilitohet dhe do të kthehet në identitet"- deklaroi Ministri Koka. Ministri i Mjedisit theksoi se mbrojtja e pyjeve dhe kullotave nga zjarret është ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Mjedisit. Pyjet dhe kullotat janë burimet më të rëndësishme natyrore të vendit. Me këto pasuri janë të lidhura interesat jetësore, ekonomike dhe ekologjike të popullatës së qyteteve dhe në fshatra, që jetojnë përrth këtyre pasurive natyrore.

VAZHDON DISKUTIMI PËR DRAFT LIGJIN E PYJEVE

Ministria e Mjedisit, zhvilloi dëgjuesën me publikun për projektligjin "Për Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kulloror Kombëtar në Republikën e Shqipërisë". Të pranishëm në këtë takim ishin një numër i madh ekspertësh të pyjeve, profesorë, profesionistë të lirë, përfaqësues të shoqatave të ndryshme që operojnë në fushën e pyjeve dhe kullotave, punonjës të drejtorive rajonale të pyjeve, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, etj.

Projektligji ka për qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, pasuri kombëtare me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe tokës, në ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhues, ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Ky projektligji synon të adresojë problematikat e ndeshura në vite dhe mangësitë e mëparshme legjislative.

Risi e këtij projektligji është transferimi i funksionit administrues të gjithë fondit pyjor e kulloror kombëtar tek 61 bashkitë e reja, të cilat kanë detyrimin, në bazë të këtij projektligji, që të ngrejnjë struktura të posaçme për administrimin e pyjeve dhe kullotave, që kanë brenda juridiksionit të tyre.

Projektligji ka si objektiv administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kulloror kombëtar, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, të pasqyruar në dokumentet strategjikë dhe angazhimet në kuadrin e konventave, marrëveshjeve, protokolleve dhe traktateve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturorë, në interes të të gjithë shoqërisë.

Rregullat, detyrimet, të drejtat, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e institucioneve shtetërore, të njësive të qeverisjes vendore, pronarëve dhe biznesit privat, për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kulloror kombëtar përbëjnë thelbin e diskutimeve të shumta e të frytshme në këtë dëgjuesë.

Në vazhdim të procesit, grupet e ndryshme të interesit kanë sjellë komentet, sygjerimet dhe opionencat e tyre në lidhje me draft ligjin e hartuar nga ekspertët e Ministrisë së Mjedisit. Këto komente po shqyrtohen nga Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve në Ministrinë e Mjedisit.



"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimin të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, xituar dhe bashkë-ruadur veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilituar opinionin publik".

NË KËTË NUMËR:

MINISTRI KOKA — PYJET PASURIA JUAJ, RUAJENI SE NUK TJETËRSOHEJ FQ 1

ARZM: & LEJET MJEDISORE FQ 2

DWGËSAT E PUBLIKUT FQ 3

AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE FQ 4

MINISTRI KOKA TAKOHET ME AMBASADORIN E OSBE –SË



Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka zhvilloi një takim me Ambasadorin e OSBE-së në Shqipëri, z. Florian Raunig dhe Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, z. Bledi Çuçi. Takimi konsultativ u përqendrua me vlerësimin e riskut të korrupsionit në fushën e mjedisit.

Ambasadori Raunig vlerësoi punën e Ministrisë së Mjedisit në këto 20 muaj duke vlerësuar reformat ligjore dhe administrative të realizuara në fushën e mjedisit duke theksuar se mjedisi zë një vend të veçantë në hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në.

Nga ana e tij Ministri Koka falenderoi Ambasadorin Raunig për mbështetjen dhe sugjerimet e vlefshme që OSBE ka dhënë dhe jep në fushën e mjedisit.

Ministri Koka theksoi se është punuar intensivisht për kryerjen e reformave në mjedis, rritjen e performancës së institucioneve, rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e kontrollit, rritjen e transparencës dhe sjelljen e mjedisit në vëmendje të shoqërisë shqiptare. “Kemi bërë mjaft refor-

ma, por puna vazhdon për të përmirësuar legjislacionin në fushën e mjedisit me qëllim arritjen e standardeve të Bashkimit Europian”- tha Ministri Koka.

Gjatë takimit, Ministri i Mjedisit, Ministri i Çështjeve Vendore dhe Ambasadori i OSBE-së, ndanë të njëjtin mendim mbi impaktin pozitiv të reformës administrative territoriale në zgjidhjen e problematikave në fushën e mjedisit.

OSBE-ja ka qënë e pranishme në Ministrinë e Mjedisit në fushën e Implementimit të Konventës së Aarhusit “Konventa mbi të drejtën e Informimit, Pjesëmarrjes së Publikut në Vendimarrjes dhe të drejtës për t’ju drejtuar gjykatës për Çështje Mjedisore”.

Që nga viti 2006 kemi pasur dy Memorandume bashkëpunimi me prezencën e OSBE-së në Shqipëri.

Memorandumi i Parë i Mirëkuptimit: “Për Bashkëpunimin në fushën e informacionit mjedisor dhe zbatimin e kërkesave të Konventës së Aarhus-it në Shqipëri” e nënshkruar më Nëntor 2006 me një kohëzgjatje prej 2 vitesh. Gjatë kësaj periudhe 2006-2008 u mundësua ngritja e Qendrave të Aarhus-it në Tiranë, e vendosur brënda Sektorit të

Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, si dhe hapja e Qendrave të Informacionit Aarhus në Vlorë dhe Shkodër

Këto qendra shërbejnë si një hallkë e rëndësishme e dhënies së informacionit mjedisor në shpërndarje shumë të përshtatshme geografike.

Bashkëpunimi i rëndësishëm ka qënë gjatë viteve 2008, nëpërmjet nënshkrimit të një memorandumi të dytë bashkëpunimi në fushën e Pjesëmarrjes së Publikut në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimin e Ndikimit Strategjik. Gjatë kësaj periudhe me mbështetjen e OSBE-së u organizuan trajnime për zyrtarët shtetërorë lidhur me përgjegjësitë e tyre sipas Konventës Aarhus në qytet e Tiranës, Vlorës, Shkodrës; si dhe u organizuan degjese publike për çështje të ndryshme: si fillimi i projektit për landfillin e Velipojës, organizimin e aktivitetetve për pastrimet e plazheve etj.

OSBE ka qënë prezente në vitet e fundit dhe me largimin e 116 ton mbetje kimike, të cilat ndodheshin të paketuara pranë prefekturës së Tiranës.

AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA: TRAJNIM PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE



Në datat 22 – 24 korrik, Ministria e Mjedisit dhe AKZM zhvilluan një trajnim të punonjësve të Zonave të Mbrojtura Detare mbi Hartimin e Planeve të Biznesit për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare.

Aktiviteti nisi më datën 22 korrik në Tiranë, për të vazhduar më tej në Himarë e Porto Palermo, si zona më e re e mbrojtur. Trajnimi synonte promovimin e mekanizmave të qëndrueshëm për financimin e zonave të mbrojtura në

shkallë lokale dhe kombëtare, duke siguruar mjetet e nevojshme, ekspertizën dhe shembujt konkret, me qëllim inkurajimin dhe mbështetjen e autoriteteve lokale dhe kombëtare të ngarkuara për ruajtjen e biodiversitetit, për të zbatuar të tillë mekanizma pas këtij trajnimit.

Z. Zamir Dedej, Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, u shpreh se “Ministria e Mjedisit, me krijimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, i ka dhënë shumë prioritet zhvillimit të Zonave të Mbrojtura, por për të arritur këtë duhen shumë fonde dhe

aktivitete. Do të jenë 3 drejtime kryesore të punës sonë; së pari, të kuptuarit më mirë të menaxhimit financiar; drejtimi ligjor dhe donatorët. Në muajt shtator dhe tetor do të kemi gati një draft ligjor për zonat e mbrojtura dhe një nga aspektet kryesore të tij do të jetë gjenerimi i të ardhurave nga këto zona. Ky draft do të diskutohet dhe me grupet e interesit”.

Trajnimi u realizua me mbështetjen financiare të RAC/SPA dhe UNEP/MAP, në bashkëpunim me Rrejtin për Mbrojtjen e Natyrës.

LEJET MJEDISORE QERSHOR 2015

SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
TEKI	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Zona minerare nr. 532/3, Komuna Martanesh, Bulqizë, Dibër	Refuzim	Tipi B
COLACEM ALBANIA SHPK	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret.	Balldre, Lezhë	Miratim	Tipi B
LIMAK INSAAT SANAYI ADI ORTAKLIGI (LC – 3226)	Transportim i gomave të përdorura.	Fshati Banjë, Komuna Klos, Qarku Elbasan	Refuzim	Tipi B
XH. F. KACOS	Grumbullim dhe transportim të mbetjeve metalike prej hekuri dhe çeliku dhe atyre me ngjyrë (skrap)	Belorta, Bulgarec, Korçë	Refuzim	Tipi B
RENCI	Transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme (Ujëra të zeza, llumra).	Ura Vajgurore, Berat	Miratim	Tipi B
KILIC AQUACULTURE ALBANIA sh.a (LC –3103)	Rritje intensive e peshkut	Në verilindje të Laçit të Vaut të Dejës	Miratim	Tipi B
KILIC AQUACULTURE ALBANIA sh.a (LC–3255)	Rritje intensive e peshkut	Vau Dejës, Prefektura Shkodër	Miratim	Tipi B
C.A.E.	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Komuna Mbrostar, Qarku Fier	Miratim	Tipi B
SMO VATAKSI	Aplikimi i bërë për transferim	Bërdicë, Shkodër	Miratim	Tipi B

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS QERSHOR 2015

Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	GRUPI LEI	VP Ndërtim kapanoni	Ishëm, Durrës	Vendim për VNM Paraprake
2	PRO - FAST- SHPK	VP Ndërtim shtese kompleksi Pro-Fast, përdorim thertore	Boboshticë, Korçë	Refuzim për VNM Paraprake
3	I.X.H.E.M	VP Godinë 2 kate + bodrum	Vlashaj, Maminas, Durrës	Vendim për VNM Paraprake
4	KOMUNA BUJAN	VP Ndërtim ujësjellësi	Bujan, Kukës	Vendim për VNM Paraprake
5	KOMUNA E DROPULLIT TË POSHTËM "ENT PUBLIK"	VP Rikonstruksion i rrugës hyrëse të fshatit	Goranxi, Dropull i Poshtëm, Gjirokastrë	Vendim për VNM Paraprake
6	E.M.K.	VP Ndërtim 3 kate banimi	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
7	BASHKIA DIVJAKE 2819	VP Sistemim dhe asfaltim i rrugëve	Divjakë, Fier	Vendim për VNM Paraprake
8	BASHKIA DIVJAKE 2821	VP Ndërtim dhe sistemim dhe asfaltim i rrugëve "Fitorja" Kongresi i Manastirit"	Mizë, Divjakë, Fier	Vendim për VNM Paraprake
9	LAMNICA	VP Shfrytëzim i kromit me nëntokë	Zona konkurruese 205/1 Përroi i Propshtit, Bytyç, Kukës	Vendim për VNM Paraprake
10	3 - D	VP Linjë prodhimi betoni	Shkozë, Durrës	Vendim për VNM Paraprake
11	JË & AL	VP Godinë banimi 2 kate	Rruga e Tallusheve, Kavajë, Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
12	ASTRIT MËNALLA	VP Kompleks Turistik me 10 vila banimi	Parcela 12/c , Gjinar, Elbasan	Vendim për VNM Paraprake
13	MALI LEZHE	VP Fabrike prodhim këpucësh	Ishull-Shëngjin, Lezhë	Vendim për VNM Paraprake
14	G & P	VP Kompleks vila individuale banimi	Mullet , Petrelë, Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
15	ITALCONSTRUZIONE	Vp Kapanon	Maminas, Durrës	Vendim për VNM Paraprake
16	A & A SECURITY SURVEY	VP Godinë Banimi	Mat, Dibër	Vendim për VNM Paraprake

VIJOJNË DËGJESAT E PUBLIKUT PËR LEGJISLACIONIN MJEDISOR

Vijon zbatueshmëria e Konventës së Aarhusit dhe e legjislacionit mjedisor në lidhje me rritjen e informimit të publikut dhe tërheqjes së mendimit të publikut për legjislacionin mjedisor që hartohet nga Ministria e Mjedisit. Më poshtë po japim shkurtimisht përmblidhje të vetëm dy prej dëgjësive të organizuara së fundmi.



30 Qershor 2015 - Ministria e Mjedisit organizoi dëgjësën me publikun për draft-vendimin e Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e Ekosistemit Natyror Detar-Bregdetar të Gjirit të Porto Palermos-Llamani "Park Natyror". Në takim ishin të pranishëm përfaqësues së Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura dhe të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, drejtuesja e projektit UNDP-së përfaqësues të shoqërisë civile e të shoqatave të ndryshme mjedisore. Gjatë dëgjësës u bë një prezantim i draftit, për shpalljen e ekosistemit natyror detar-bregdetar të Gjirit të Porto Palermos-Llamani, si zonë të mbrojtur me statusin "Park Natyror", si dhe një pasqyrim i gjendjes dhe vlerave të natyrës e të biodiversitetit.

Qëllimi i këtij projektvendimi është që të shpallë, të ruajë dhe të administrojë këtë ekosistem detar dhe

bregdetar të Shqipërisë, me një vlerë të veçantë nga pikëpamja e biodiversitetit, si pjesë të territorit të vendit me një status mbrojtjeje të caktuar. Ky projektvendim do të formtojë më tej mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, që lidhet me shtimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, ruajtjen dhe përditësimin e statusit të habitateve dhe llojeve, menaxhimin e integruar të tyre dhe ngritjen e rritjes ekologjike "Natura 2000". Gjithashtu ky projektvendim lidhet me standardet mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.



7 Korrik 2015 - Në Ministrinë e Mjedisit u zhvillua dëgjësja e publikut për draft-vendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis". Në këtë takim mermin pjesë përfaqësues të shoqatave mjedisore dhe ekspertë mjedisorë, si dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Dëgjësja u hap nga Drejtor i Mjedisit z. Redi Baduni, i cili shprehu rëndësinë e kësaj dëgjësjeje për të ndihmuar procesin e hartimit të legjislacionit

mjedisor e në veçanti të këtij draft-vendimi të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të ndikimit në mjedis". Më pas u bë një prezantim i rëndësishëm së hartimit të këtij projektakti, qëllimi i të cilit është krijimi i një procedure, përsa i përket rregullave, përgjegjësisë, afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM-së) pa përfshirjen e QKL-së.

Ky projektvendim synon të përcaktojë rregullat dhe kriteret për ngritjen e një sistemi kombëtar, bashkëkohor dhe të integruar të vlerësimit të ndikimit në mjedis për të arritur në një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis. Ai përcakton në mënyrë të qartë dhe të plotë procedurën e vlerësimit që ndiqet nga personat fizikë e juridikë në rolin e zhvilluesit të projektit dhe nga administrata dhe institucionet qendrore e vendore në rolin e organeve vendimarrëse. Gjithashtu, draft-vendimi ndikon në rritjen e bashkëpunimit institucional për mbrojtjen e mjedisit dhe lehtësimin e rritjen e sigurisë për investimet në vend. Hartimi i këtij vendimi përbush rekomandimet e Bashkimit Europian në lidhje me procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.



THËNIA E MUAJIT

“Në mes të kaosit të qyteteve, një pjesë e jotja gjithmonë lëngon për qetësinë e pyjeve”.

— Ram Mohan

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE



TË MBROJMË LUMENJTË TANË!

Kjo moto ka bashkuar një grup shoqatash mjedisore, si dhe një grup ekspertësh, që punojnë në fushën e mjedisit, të cilët kërkojnë hartimin e një moratoriumi për ndalimin e licencave dhe koncesioneve për ndërtimin e HEC-ve në shteretërit e lumenjve shqiptarë.

Ky grupim, i cili u krijua Ditën Botërore të Ujit, më 22 Mars 2015, po e përshkallëzon lëvizjen e tij dhe së fundmi organizoi një takim me grupin parlamentar të Komisionit të Vepërimitarive Prodhuese, Tregëtisë dhe Mjedisit. Në këtë takim merrnin pjesë përveç deputetëve të të gjitha forcave politike dhe përfaqësues të Kryeministrisë, Sekretariatit Teknik për ujën dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturrës. Në takim u mbajt një qëndrim i shoqërisë civile dhe u dorëzua letra e pozicionimit për sektorin e ujit.

Në këtë letër, formuloheshin qëndrimet e tyre, si më poshtë:

“Në fund të një rrugëtimi prej afro 6 muajsh në të gjitha basenet lumore, ku jemi takuar me profesionistë të ndryshëm dhe kemi mbërritur në përfundimet e mëposhtme, të cilat pëmbledhin dhjetra çështje e rekomandime, të cilat më vete janë shkruar në një letër pozicionimi, për t’u përcjellë zyrtarisht pranë kwtij komisioni si dhe 7 institucioneve në nivel të lartë në vend.

Ne kemi arritur në përfundimin se:

1. Në nivel të kuadrit ligjor

1.1. Kuadri ligjor mbetet paharmonizuar (burime ujore, energji, ujtje, ujësjellësa), e nuk garanton balancë në sektor, nuk qartëson detyrat, kompetencat dhe marrëdhëniet institucionale;

1.2. Ka mungesë totale të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Planeve Hapsinore, në rregullimin e ndërhyrjeve në burimet ujore.

2. Në nivel institucional

2.1. Ka një paqartësi institucionale, mungesë koordinimit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe veçanërisht në nivel baseni lumor mbi mënyrën e menaxhimit të ujit në natyrë dhe atij që përdoret për qëllime ekonomike dhe jetese;

2.2. Këshillat e Baseneve Ujore, të cilët duhet të jenë gardianët e balancës ujore, janë ose në pafuqi ose në padijeni të funksioneve të gjera që ka administrimi i

basenit;

3. Në nivel ndërhyrjesh investimesh

3.1. Ka investime të panumërta në barriera, marrje zhavorresh, ndërtim rrugësh, hidrocentralesh dhe veçanërisht hidrocentralesh, digash e sisteme marrje, të cilat në pothuaj të gjitha rastet janë në shkelje të disa ligjeve dhe në raste të tjera nuk kanë marrë parasysh dëmin e rëndë që i shkaktohet trupës ujore në tërësi;

3.2. Ka mbishfrytëzim dhe keqshfrytëzim të burimeve ujore për prodhim energjie dhe është rreziku që i kanoset botës së gjallë dhe drejtpërdrejt banorëve të shumë zonave në Shqipëri;

3.3. Shfrytëzimi pa kriter i ujit nga individët dhe biznesat.

Pothuajse ka mungesë totale të përgjegjësisë sociale dhe mjedisore të bizneseve që përdorin ujën.



E gjitha kjo ka filluar të japë efektet e veta në:

1. Ndotje të lartë të baseneve ujore dhe veçanërisht atyre nëntokësore;

2. Rënie të sasisë ujit e për pasojë mungesë së theksuar të ujit për pije;

3. Rritjen e stresit tek disa komunitete në Shqipëri, për shkak të devijimit të ujit, të cilat kanë filluar të shfaqen dhe me protesta;

4. Degradim të sistemeve ujtëse në të gjithë vendin, uljen e potencialit bujqësor;

5. Degradimin e potencialit turistik të vendit nga mungesa e sasisë së ujit për zonat bregdetare dhe funksionimi i dobët i sistemeve të trajtimit të ujit;

6. Efëncensë e dobët deri në mungesë të principeve minimale të menaxhimit të ujit për përdorim jetik;

7. E gjithë kjo po shkakton kosto të situara nga keqpërdorimi dhe humbja e burimeve, të cilat po i postohen të ardhmes, fëmijëve të këtij vendi.

Përveç sugjerimeve të tjera të paraqitura në letërën e pozicionimit përfaqësuesit e shoqërisë civile propozojn:

1. Uji duhet të menaxhohet “nga një dorë” e vetme. Ngritja e një Agjencie për Menaxhimin e Burimeve Ujore mund të sjellë në një menaxhim më të qartë në ujin si burim natyror dhe ujin si e mirë publike;

2. Përgjegjshmëria dhe sjellja e biznesit duhet fuqizuar më

tej. Të gjitha industritë që përdorin ujën duhet të sigurojnë përdorim eficient të tij dhe trajtim përfundimtar të ujërave të përdorur dhe rehabilitim të burimit sa herë është e kërkuar dhe e mundur;

3. Ndalimin e investimeve në vepra të mëdha si hidrocentralet deri në përgatitjen e VSM dhe sigurimit të balancës ujore, kadastrës dhe strategjisë së ujit.

TAKIM ME PËRFITUES TË GRANTEVE TË VOGLA NË PARKUN KOMBËTAR “SHEBENIK-JABLLANICË”

Më 7 Korrik 2015 përfaqësues të Shoqatës “Për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri” (PPNEA) u takuan në rajonin Librazhdit me përfaqësues të pesë NGO-ve përfitues të granteve të vogla të dhëna në kuadër të projektit “Për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit” me fokus promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Parkun Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”.

Shoqatat u mblodhën së bashku duke ndarë me ne eksperiencat e tyre gjatë implementimit të këtyre projekteve, rezultatet e arritura e njëkohësisht vështirësitë e hasura dhe sfidat për të ardhmen.



Kjo foto është realizuar në pyllin e Krastës në zonën e Makareshit, në Krujë. Ato pasqyrojnë momente nga puna për kujdesin ndaj 76 500 fidane pishe të egër (pinus halepensis) të cilat u mbollën në 30.6 ha sipërfaqe pyjore të degraduar.

Ky pyllëzim realizohet në kuadër të projektit “Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimeve të objektit Makaresh në ekonominë pyjore ‘Krasta e Krujës’”; projekt i cili po zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me financim nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet Fondit për Zhvillimin Rajonal.